

VENDIM
Nr. 932, datë 30.9.2013

PËR UNIFIKIMIN E KOMPETENCAVE TË INSPEKTORATIT NDËRTIMOR URBANISTIK
KOMBËTAR (INUK) NË ZONAT ME RËNDËSI KOMBËTARE DHE
NË TERRITOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 10/1 e 16 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) i ushtron pa asnjë kufizim paraprak kompetencat e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në çdo rast kur ai konstaton objekt të kundërligjshëm, me ose pa leje ndërtimi, në të gjitha zonat e përcaktuara, si zona të rëndësisë kombëtare, me ligj, akte nënligjore apo me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT).

2. Në rastet kur INUK-ja konstaton objekte në ndërtim e sipër në të gjithë territorin, përfshirë edhe zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare, dhe kur Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) dhe/ose autoriteti përgjegjës i planifikimit nuk ka zbatuar përgjegjësitë ligjore të përcaktuara në nenin 83 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, atëherë INUK-ja ushtron menjëherë kompetencat e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007.

3. INUK-ja ushtron menjëherë me autoritet të plotë përgjegjësitë e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007, për të gjitha objektet e kundërligjshme, me ose pa leje ndërtimi, në të gjithë territorin kur konstaton se INUV-ja e komunës/bashkisë ka kryer veprime ose mosveprime në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore, të parashikuara në ligjin nr.9780, datë 16.7.2007.

4. INUK-ja, qoftë edhe kryesisht, kryen inspektime dhe kur është rasti ushtron kompetencat e përcaktuara në nenet 9, 10 e 10/1 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” në të gjitha zonat e rëndësisë kombëtare, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, si dhe pranë të gjitha zonave dhe objekteve, të cilat paraqesin karakteristika të veçanta kulturore, historike, sociale, arsimore, shëndetësore, mjedisore, turistike, industriale apo infrastrukturore etj, kur mjedisi i tyre është dëmtuar, apo shkatërruar tërësisht nga zhvillimi i ndërtimeve të objekteve:

a) pa leje ndërtimi;

b) me leje ndërtimi, por të realizuara me shkelje të kushteve urbanistike të lejeve të ndërtimit;

c) me leje ndërtimi të kundërligjshme;

ç) dhe të strukturave/ndërtimeve në proces legalizimi, të cilat bien në kundërshtim me kërkesat ligjore, të përcaktuara në vendimin nr.438, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim apo që legalizohen ose jo”. Në këto raste, është ALUIZNI autoriteti përgjegjës, i cili konfirmon moskualifikimin për legalizim të këtyre objekteve dhe njofton INUK-në.

5. Për efekt të ushtrimit të përgjegjësisë të INUK-së në territorin e zonave me rëndësi kombëtare apo të zonave të miratuara në KKT, çdo ndërtesë/strukturë nëntokësore dhe/ose e ngritur mbi tokë, në fazën fillestare apo të përfunduar të ndërtimit, e përhershme apo e përkohshme, e lidhur në mënyrë të qëndrueshme ose të përkohshme me truallin, konsiderohet objekt i kundërligjshëm kur rezulton se gjendet në njërin apo disa nga kushtet e mëposhtme:

a) Është pa leje ndërtimi;

b) Është me leje ndërtimi, por me shkelje të plotë të kushteve urbanistike të miratuara në lejen e ndërtimit, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi dhe/ose në kundërshtim me planet, kombëtare apo vendore, të zhvillimit;

c) Për këtë objekt ka kaluar afati ligjor i përcaktuar në lejen e ndërtimit për përfundimin e objektit

dhe/ose objekti është braktisur nga investitori/subjekti ndërtues/pronari;

ç) Është pa dokumentacion tekniko-ligjor që të vërtetojë ligjshmërinë tekniko-ligjore të objektit;

d) Objekti rezulton me shkelje të lejes së legalizimit ose me leje legalizimi të miratuar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi për legalizimet.

6. Policia e Shtetit, kur konstaton punime ndërtimore të kundërligjshme në të gjithë territorin, merr masat ligjore përkatëse dhe njofton menjëherë INUK-në.

7. Në ushtrimin e kompetencave në prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme INUK-ja bashkëpunon dhe mbështetet nga Policia e Shtetit.

8. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të nxjerrë udhëzime të hollësishme metodike për zbatimin e praktikës së unifikuar sipas këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama